



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 521/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.08.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Rroku Guest” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me objekt “Sistemim, asfaltim rruga “Qendër Mes - Qendër Dragoç”, me nr. REF-59821-03-29-2018, me fond limit 15,884,982 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.05.2018, nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “S.M.O. Union” sh.p.k., në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Rroku Guest” sh.p.k
Adresa: Rr. “Nazmi Kryeziu”, Nd.1/1, H.2, Ap. 8, Shkodër.

Autoriteti kontraktor:

Bashkia Shkodër
Adresa: Rr. “13 Dhjetori”, Nr.1, Shkodër.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për

organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar;

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 30.03.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e hapur”, me objekt “Sistemi, asfaltim rruga “Qendër Mes - Qendër Dragoç”, me nr. REF-59821-03-29-2018, me fond limit 15,884,982 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.05.2018, nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër.

II.2 Në datën 07.05.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 29.05.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. "Rroku Guest" sh.p.k.	10,589,670 lekë pa tvsh Skualifikuar;
2. "S.M.O. Union" sh.p.k.	10,740,135 lekë pa tvsh Kualifikuar;
3. "Varaku-E" sh.p.k.	10,863,405 lekë pa tvsh Kualifikuar;
4. "Albavia" sh.p.k.	10,996,020 lekë pa tvsh Kualifikuar;
5. "Delia Impex" sh.p.k.	11,195,100 lekë pa tvsh Kualifikuar;
6. "Nika" sh.p.k.	12,670,057 lekë pa tvsh Kualifikuar;
7. "B 93" sh.p.k.	13,061,895 lekë pa tvsh Kualifikuar;
8. "MF Invest Group" sh.p.k.&"Mane/S" sh.p.k.	13,420,250 lekë pa tvsh Skualifikuar;
9. "Kacdedja" sh.p.k.	13,505,293 lekë pa tvsh Kualifikuar;
10. "Alb-Tiefbau" sh.p.k.	14,051,016 lekë pa tvsh Kualifikuar;
11. "Egland" sh.p.k.	14,461,388 lekë pa tvsh Skualifikuar;

II.4.Nga verifikimet e kryera, rezulton se operatori ekonomik "Rroku Guest" sh.p.k. është njoftuar nëpërmjet Sistemit e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsyet si më poshtë vijon:

"-Nuk plotesoni piken 2.3.13"Per Kapacitetin teknik" pasi makinerite e paraqitura ne kete procedure prokurimi deri me date 07.05.2018, dita e hapjes se ofertave, jane te angazhuara edhe ne kater kontrata te tjera te paperfunduara me Bashkine Shkoder si me poshte: 1- Rikonstruksion rruga "Sami Repishti" 2- Ndërtim parcela të reja varresh Varreza NJA Rrethina, (Ndertim Varreza Publike) 3- Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Beltojë 4- Ndërtim trotuari nga kanali deri tek kisha, Sektor Velipojë" Te gjitha makinerite pa perjashtim te paraqitura ne shtojcen e makinerive jane te njejta me makinerite e paraqitura ne procedurat e cituara me lart -Nuk plotesoni piken 2.3.7"Per Kapacitetin teknik" pasi inxhinieret I.N., E.K.,A.G pjese e stafit te shoqerise, te deklaruar te paangazhuar, jane te angazhuar edhe ne kater kontrata te tjera me Bashkine Shkoder sipas deklarimeve te bera ne keto procedura. Gjithashtu edhe fuqia punetore e paraqitur ne kete procedure prokurimi eshte e angazhuar ne kontratat e hapura dhe akoma te paperfunduara me Bashkine Shkoder. Sa me lart ju nuk dispononi mjetet, stafin dhe fuqine punetore per te realizuar kontraten pasi ato jane te angazhuara ne kontrata te tjera dhe akoma te paperfunduara me vete Bashkine Shkoder."

II.5.Në datën 04.06.2018 operatori ekonomik ankimues "Rroku Guest" sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, si dhe kundërshton kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik "S.M.O Union" sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6.Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 8729/1 Prot. datë 11.06.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues "Rroku Guest" sh.p.k., duke mos e pranuar ankesën e tij, me argumentimin si më poshtë vijon:

[...]Nga shqyrtimi i dokumenteve të paraqitur në sistemin elektronik të APP, ne permbushje te ketij kriteri ju keni paraqitur “Deklarate mbi angazhimin e makinerive“ ku shpreheni se makinerite e kerkuara ne DST nuk jane te angazhuara ne kontrata te tjera por vetem per kete objekt. Gjithashtu deklaroni qe vendodhja e mjeteve ne pronesi eshte perballe kompleksit Buna park. tek Ura e Bunes, ndersa e atyre me qera eshte ne Kamez dhe Vrake ne Malesi e Madhe. Nisur nga deklarimi i mesipemi rezulton qe makinerite e kerkuara ne kete procedure prokurimi ju si operator ekonomik nuk i keni te angazhuara ne kontrata te tjera por ndodhen ne kantier ku edhe mund te verifikohen nga KVO. Ky deklarim bie ndesh me deklarimet tuaja te shprehura ne shtojca 11 “Deklarate mbi kontratat e lidhura dhe/ose ne proçes” si dhe formularin e ankeses ku pretendoni qe keni dy kontrata ne zhvillim e siper ku per njerën pretendoni qe eshte ne mbarim(8 ore pune) dhe per tjetren punimet jane ne masen 50% te realizuara. Ne dokumentet e paraqitura ne proceduren e prokurimit zhvilluar me date 07.05.2018 eshte edhe shtojca 11 “Deklaratë mbi kontratat e lidhura dhe/ose ne proçes” ku ju deklaroni se punimet ne kontraten me objekt: Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Beltoje jane te perfunduara ne masen 65% ndersa per kontraten me objekt ‘Ndërtim trotuari nga kanali deri tek kisha, Sektor Velipojë" punimet nuk kane filluar akoma. Nisur nga ky fakt rezulton se ju keni nje kontrate te paperfunduar ne masen 35% dhe nje kontrate tjeter qe punimet nuk kane filluar akoma. Sa me siper pretendimet tuaja qe kontratat jane ne perfundim e siper nuk qendrojne pasi KVO vlereson dokumentacionin qe ju vete keni hedhur ne sistemin e APP ne permbushje te kriterëve te vendosura ne DST dhe jo situacionet me date 04.06.2018 kur ju keni dorezuar formularin e ankeses per vleresimin e bere nga KVO. Ne shtojcen nr.10 "Mbi disponimin e makinerive" qe ju keni paraqitur ne proceduren e prokurimit objekt ankimimi, keni deklaruar mjetet dhe makinerite e meposhtme:

Ne pronesi

- 1. 2 Betoniere 0.5 m3 - Fature Nr.98 date 20.04.2010*
- 2. Armature derrase 6m3 Fature - Nr.145 date 10.11.2015*
- 3. Asfaltoshtruese Bilelli+Rrul asfalti Bomag - Kontrate shitblerje nr.rep 135 nr.kol 75*
- 4. Autobetoniere Dieci 3m3 - Deklarate Doganore R4091 date 21.06.2013*
- 5. Betoniere&Motorr(5 cope) + 7 Karroca – Faturë nr.908 date 26.11.2014*
- 6. Fadroma JCB – Targa SH697FV*
- 7. Kamion mbi 20 Ton DAF – SH7643E*
- 8. Matrapik cope 2 – Fature nr.113 date 23.04.2010*
- 9. Rrul Terex 3 Ton – Deklarate doganore R6396 date 06.02.2010*
- 10. Rrul gome cilinder mbi 12 Ton – Fature nr.13 date 17.02.2014*
- 11. Skeleri – Fature nr.13 date 05.06.2017*

Me qera

- 1. Autobitumatrice - Targa AA230HV*
- 2. Autobot uji - Targa AA 703 OM*
- 3. Kamion me vinc - Targa AA 043 KD*

Ne proceduren e prokurimit me objekt Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Beltoje“ keni deklaruar se dispononi makinerite e meposhtme sipas shlojces nr.10" Mbi disponimin e makinerive“

Ne pronesi

- 1. 2 Betoniere 0.5 m³ - Fature Nr.98 date 20.04.2010*
- 2. Armature derrase 6m³ - Fature Nr.145 date 10.11.2015*
- 3. Asfaltoshtruese Bitelli+Rrul asfalti Bomag - Kontrate shitblerje nr.rep 135 nr.kol 75*
- 4. Autobetoniere Dieci 3m³ - Deklarate Doganore R4091 date 21.06.2013*
- 5. Betoniere&Motoorr(5 cope) + 7 Karroca - Fature Nr.908 date 26.11.2014*
- 6. Fadroma JCB - Targa SH697FV*
- 7. Kamion mbi 20 Ton DAF - SH7643E*
- 8. Matrapik cope 2 - Fature nr.113 date 23.04.2010*
- 9. Rrul Terex 3 Ton - Deklarate doganore R6396 date 16.02.2010*
- 10. Rrul gome cilinder mbi 12 Ton - Fature nr.13 date 17.02.2014*
- 11. Skeleri - Fature nr. 13 date 05.06.2017*

Me qera

- 1. Autobitumatrice - Targa AA230HV*
- 2. Autobot uji Targa AA703OM*
- 3. Kamion me vinc Targa AA043KD*

Ne proceduren e prokurimit me objekt Ndertim trotuari nga kanali deri tek kisha, Sektor Velipoje“ keni deklaruar se dispononi makinerite e meposhtme sipas shlojces nr.10 “Mbi disponimin e makinerive”

Ne pronesi

- 1. 2 Betoniere 0.5 m³ - Fature Nr.98 date 20.04.2010*
- 2. Armature derrase 6m³ - Fature Nr.145 date 10.11.2015*
- 3. Autobetoniere Dieci 3m³ - Deklarate Doganore R4091 date 21.06.2013*
- 4. Betoniere&Motoorr(5 cope) + 7 Karroca - Fature Nr.908 date 26.11.2014*
- 5. Fadroma JCB - Targa SH697FV*
- 6. Kamion mbi 20 Ton DAF - SH7643E*
- 7. Matrapik cope 2 - Fature nr.113 date 23.04.2010*
- 8. Rrul Terex 3 Ton - Deklarate doganore R6396 date 16.02.2010*
- 9. Rrul gome cilinder mbi 12 Ton - Fature nr.13 date 17.02.2014*

Me qera

- 1. Autobot uji Targa AA703OM*
- 2. Kamion me vinc Targa AA043KD*

Sic shihet edhe me lart, makinerite dhe paisjet e paraqitura ne proceduren e prokurimit objekt ankimimi jane te njejta me dy kontratat e siperpermendura nga te cilat nje kontrate eshte e paperfunduar ne masen 35% dhe nje kontrate tjeter qe punimet nuk kane Filluar akoma, deklarime te dhena nga vete ju me date 07.05.2018, dita e hapjes se ofertave. Te njejtat makineri jane paraqitur edhe ne kontraten me objekt “Rikonstruksion rruga Sami

Repishti“ e cila eshte e pezulluar por akoma e paperfunduar. Pretendimet tuaja se ne kontratat Ndertim trotuari nga kanali deri tek kisha, Seklor Velipoje" dhe "Rikonstruksion i Rruges se Varrezave Belloje" makinerite e paraqitura jane sa tretishi i atyre te kerkuara nuk qendrojne pasi anetari tjetër i bashkimit të shoqerive, “Kthella“sh.p.k ka vetem 5% te punimeve dhe makinerite e paraqitura jane per realizimin e vetem e ketij 5% punimeve, punime qe ka marre vete ti realizoje ne baze te aktmarreveshjes se bashkepunimit. Nisur sa me lart dhe deklaratave qe ju vete keni paraqitur ne proceduren e prokurimit me objekt: “Sistemim asfaltim rruga "Qender Mes Qender Dragoç”, rezulton se makinerite dhe paisjet e paraqitura jane dhe do te jene te angazhuara ne kontrata te tjera me vete Autoritetin Kontraktor Bashkia Shkoder.

Bazuar në DST e publikuara nga AK. kapaciteti teknikpika 2.3.7 është shprehur si më poshtë: Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesin një deklaratë nga Administratori i Shoqerise ofertuese se inxhinieri i ndertimit, inxhinieri hidroteknik dhe inxhinieri topograf janë te disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për te vertetuar deklarimin e mesiperme. Për plotësimin e kësaj pike ju keni paraqitur nje deklaratë ku citoni se inxhinieret e mesiperme janë te disponueshem per realizimin e kesaj kontrate por nga verifikimet rezulton se te njejtet inxhiere jane deklaruar të disponueshem edhe ne kater kontrata te tjera më vete Bashkine Shkoder, si rrjedhoje keta kater inxhinieret jane te angazhuar edhe ne kater kontrata te tjera ne zbatim dhe akoma te papërfunduara. Në formularin e ankesës drejtuar Autoritetit Kontraktor pretendimet tuaja janë ne lidhje me fuqine punetore jane se ju keni fuqi puncture te mjaftueshme per te realizuar kontraten dhe se kontratat tjera jane ne perfundim dhe nuk kane nevojte per fuqi punetore shtese. Bazuar në DST e publikuara nga AK, kapaciteti teknik pika 2.3.5 është shprehur si më poshtë: Operatori ekonomik ofertes duhet të ketë numrin e nevojshëm të punonjësve për realizimin dhe zbatimin e kontratës. Numri mesatar vjetor i punonjesve të siguruar për periudhen Mars 2017-Mars 2018 duhet te jetë 20 (Njzet). Lidhur me këtë pikë operatori ekonomik ofertues duhet të paraqese vertetim të lëshuar nga Dega e Tatim Taksave ose Dega e Sigurimeve Shoqerore dhe Shëndetsore në të cilin të jetë i percaktuar numri i punonjesve të siguruar për secilën nga periudhat e mësipërme, shoqëruar me listepagesat perkatese E-Sig, për kontributet e sigurimeve shoqerore dhe shëndetsore. Ne plotesimin e ketij kriteri ju keni paraqitur vertetim nga dega e Tatimeve Shkoder ku rezulton se numri mesatar i punonjesve per kete periudhe eshte 36 punonjes. Sic u tha edhe me lart nga vete deklarimet tuaja rezulton qe kontrata me objekt : Ndertim trotuari nga kanali deri tek kisha, Sektor Velipoje, nuk ka filluar akoma nga zbatimi. Referuar DST te procedures me kete Objekt prokurimi rezulton se per kete objekt june kerkuar 12 punonjes ndersa ne proceduren e prokurimit me Objekt: Rikonstruksiun i Rruges se Varrezave Beltoje ku ju keni pa perfunduar edhe 35% te punimeve jane kerkuar 10 punones. Duke patur parasysh edhe dy objekte te cilat punimet jane te pezulluara por qe mund te rifillojne menjeherc atehere rezulton se ju nuk dispononi fuqine e nevojshme punetore per realizimin e kontrates me objekt:"Sistemim asfaltim rruga "Qender Mes Qender Dragoç“. Për sa më sipër skualifikimi i bërë nga KVO është i drejtë dhe i mbështetur në ligj dhe pretendimi juaj për këtë pikë nuk qendron.[...]"

II.7.Në datën 19.06.2018 operatori ekonomik ankimes "Rroku Guest" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi duke argumentuar si më poshtë vijon:

"[...]Operatori ekonomik "Rroku GUEST" shpk në bazë të arsyeve të percaktuara sa më sipër konstaton se: 1. Dy kontratat e paraqitura si të hapura dhe rrjedhimisht të papërfunduara dhe me angazhim; Kontrata 1-Rikonstruksion rruga "Sami Repishti" 2.Ndërtim parcela të reja varresh Varreza NJA Rrethina, (Ndërtim Varreza Publike), janë të hapura sepse të tilla kanë ngelur nga vetë Bashkia Shkodër, e cila në rastin e parë, pra Objekti: Rikonstruksion rruga "Sami Repishti" Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër nuk ka arritur të perfundojë procedurat ligjore për lirimin e hapësirës publike që konsiston në prishjen e disa garazheve dhe kjo ka bërë që vetëm shtresat asfaltike të cilat janë e shumta dy ditë punë të mbetën të papërfunduara dhe rrjedhimisht objekti të ngelet i papërfunduar akoma. Ndërsa në rastin e objektit të dyte "Ndërtim parcela të reja varresh Varreza NJA Rrethina, (Ndërtim Varreza Publike)" Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër sërish nuk ka arritur të përfundojë procedurat ligjore për lirimin e hapësirës publike pasi vetë Bashkia Shkodër akoma nuk ka shpronësuar pronarët e tokave në të cilat po ndërtohen parcelat e reja të varrezave, aktualisht kemi kryer të gjitha punimet e betonit dhe presim shpronësimet për të vazhduar me asfaltimin. (Këta të konfirmuara dhe nga vetë Bashkia Shkodër në pergjigjen e ankesës me datë 11/06/2018 prot 8729/1). Kontrata "Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Beltojë" në momentin e hapjes së tenderit ka qënë në përfundim dhe në momentin që kemi bërë ankesën tek AK kishin ngelur vetëm 8 orë punë për ta përfunduar objektin, pra kishte ngelur vetëm zëri i punës "Shtresë asfaltobetoni me granil guri kave, 3cm, me makineri" dhe që sot që flasim kemi një njoftim për përfundimin e punimeve me nr prot.9520 datë 14/06/2018 pra objekti ka patur afat 3 muaj, nga 19/04/2018 deri në datën 19/07/2018 dhe ne e kemi përfunduar jo vetëm përpara afateve por edhe në diferencë kohe duke treguar se jemi një operator ekonomik i besueshem në deklaratimet dhe punët e marra përsipër. Kontrata "Ndërtim trotuari nga kanali deri tek Kisha, Sektor Velipojë" është në punim e sipër ku në momentin që është bere ankesa punimet kishin përfunduar në më shumë se 50% e punimeve. Nderkohe tani qe flasim jane përfunduar 80% e punimeve duke e kryer kështu objektin jo vetëm në kohë por edhe 50 ditë përpara përfundimit të afatit duke qënë se ka patur afat përnddimi 4 muaj, që nga data 19/04/18 deri në 19/08/18, ndërkohë që ne do e përfundojmë brenda këtij muaji. Gjithashtu duam të njoftojmë AK dhe KVO që në këto dy objektet e fundit të lartpërmendura ne kemi marrë pjesë në tender si BOE (Bashkim operatorësh ekonomik) dhe makineritë e paraqitura në këto objekte janë dy për mos të thënë 3 fishi i atyre të kërkuara nga AK, por KVO nuk e ka marrë parasysh këtë fakt duke mos verifikuar të gjitha makineritë. Gjithashtu duam të vëmë në dijeni autoritetin kontraktor dhe KVO që angazhimi i makinerive do të thotë që ato makineri të jenë të paangazhuara për periudhen në të cilën ato do duhet të kryejnë proceset e punës për të cilat ngarkohet në preventiv (dhe në momentin që e ka kryer atë proces për të cilin është angazhuar ajo clirohet nga angazhimi kontrakual), por s'është e thënë që një makineri (asfaltoshtruese,

grejder, autobot, autobitumatrice, etj) të rrijë në objekt atë gjithë kohës fizike për të cilën është nënshkruar kontrata pasi që do të ishte jo e drejte ligërisht as teknikisht t'i kërkohej një operatori që nëse merr 4 objekte të gjitha me vlerë 20 000 000 lekë pa tvsh (që është mëse normale për një operator ekonomik të vogël ose të mesëm), ti kërkohej të ketë 4 asfaltoshtruese, 4 autobitumatrice, 4 autobota apo 4 grejdera kur dihet që koha fizike e punës e lejon që me nga një makineri të kryhen të katër objektet. Ne DST është përcaktuar sakte që : “Operatori ekonomik ofertues (Administratori i shoqërisë ofertuese), duhet të paraqesë deklaratë që makineritë e kerkuara ne pikën 2.3.10, nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera por vetëm për këtë objekt. Gjithashtu ne deklarate duhet te deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi. Dhe ne në deklaratën tonë kemi deklaruar që makineritë do të jenë të angazhuara vetëm për këtë objekt, pasi që kemi patur besimin e plotë, ashtu sic e kemi treguar duke përfunduar punimet në kohë rekord, që objektet që kemi patur në dorë do t'i përfundojmë përpara se të fillonim punimet në objektin për të cilin kemi ofruar një ofertë. Për këtë Autoriteti Kontraktor dhe në këtë rast KVO duhet të merrte informacion nga Zyra e Ndjekjes së Investimeve kur do të perdori si kriter skualifikues për operatorët ekonomik aftësinë zbatuese dhe angazhimin në kontratat në proces në mënyrë që vendimet të mos jenë të njëanshme dhe DISKRIMINUESE pasi që AK Bashkia Shkodër nuk ka verifikuar asnjë prej operatorëve tjerë konkruues në lidhje me angazhimin e makinerive të tyre në kontrata të tjera, shkak ky që do duhej të çojë në anulim të vendimit të KVO për të na eliminuar si diskriminues dhe trajtim jo i barabartë i operatorëve ekonomik. Ne si operator ekonomik kemi mbyllur me sukses dhe në afatet kohore të gjitha kontratat që kemi nënshkruar me Bashkinë Shkodër dhe me gjithë Autoritetet Kontraktore që kemi patur kontrata, këtë gjë KVO mund ta verifikonte shumë mirë me Zyrën përkatëse në Bashkinë Shkodër si dhe me të gjitha AK tjera që ne kemi punuar. Ka qënë vetë Bashkia Shkodër që ka patur besimin që të na shpalli fitues në 2 kontrata NJEKOHËSISHT, ku dhe sic shifet në përgjigjen që ka bërë Bashkia Shkodër ndaj ankimit tonë, kemi patur të njëjtat makineri, dhe në atë periudhë nuk ka përbërë problem për Bashkinë Shkodër, ndërkohë tani përbën problem për të që ne të fitojmë një kontratë tjetër kur ndërkohë ne i kemi përfunduar thujtse të gjitha punimet në kontratat tjera. Ky është fakt i qartë që pas këtij eliminimi nuk qëndrojnë argumente teknike dhe ligjore, por diskriminuese ndaj nesh si operator konkruues, pasi ofertat tona dorëzuar në objektet që jemi shpallur fitues kanë qënë gjithmonë ekonomikisht më të favorshme sesa të operatorëve tjerë konkruues, për këtë lejojmë edhe Komisionin e Prokurimit Publik që t'i verifikojë. 2. Ne pikën 2.3.7 te DST Shkruhet tekstualisht: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesin një deklaratë nga Administratori i Shoqërisë Ofertuese se inxhinieri i ndertimit, inxhinieri hidroteknik dhe inxhinieri topograf janë të disponueshëm për realizimin e kësaj kontrate. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryeje të gjithë verifikimet e nevojshme për te vertetuar deklarimin e mesiperm“ , pra ne kemi deklaruar që janë të disponueshem, jo që janë të pa angazhuar, për këtë i kërkojmë KVO të rishikojë me vëmendje deklaratat, pasi vetë kjo KVO e ka hequr kriterin ku duhet të deklarohet që drejtuesi teknik duhet të jetë i paangazhuar dhe gjatë gjithë kohës në objekt me një shtojcë të hedhur në sistem në datë 18/04/2018. Dhe ky arsytim vjen në vazhden e një vlerësimi të

njëanshëm dhe DISKRIMINUES duke mos përdorur të njëjtin kriter skualifikues edhe për operatorët gjerë. Në përgjigjen e autoritetit kontraktor ndaj ankesës sonë shprehet fakti që ngaqë ne i kemi shpallur të disponueshem në kontratat tjera të përfunduara tashmë apo në përfundim, do të thotë që ato janë të angazhuar dhe nuk mund të përdoren për të fituar kontrata të tjera. Argument qesharak ky besojmë ne, pasi që objektet kanë vlerë aq të vogël, dhe janë në një distancë aq të afërt saqë të skualifikosh një operator ekonomik me ofertë ekonomikisht shumë të favorshme për një argument të tillë është jo "vetëm jo teknikisht e shpjegueshme, por edhe diskriminuese. 3. Fuqia punëtore e shoqërisë sonë nga viti në vit ka ardhur duke u rritur dhe numri i punëtorëve që kërkohet në DST nuk duhet të jetë për të mbledhur dhe zbritur numrin e punëtorëve në mënyrë që KVO të vlerësojë në mënyrë të njëanshme kur i intereson asaj, pasi që këto kontrole që ka bërë për ne nuk i ka bërë për operatorët tjerë, por numri i punëtorëve është për t'i vërtetuar KVO që jemi kompani solide, duke u rritur dhe të atë për të ofruar një staf të qëndrueshëm dhe për t'i dhënë besimin që objekti do të kryhet me sukses. Arsyet e përdorura nga ju janë jo të drejta dhe diskriminuese, pasi si mund të punësojmë njerëz të tjerë nëse ju nuk na lejoni të punësojmë staf shtesë në rast të një kontrate të re ndërkohë që kam një kontratë në proces. Pra ju praktikisht thoni që s'mund të punësoni staf të ri. Gjë kjo që bie në kundërshtim me parimet e Ligjit për Prokurimin Publik ku theksohet që qëllimi i vendosjes së kriterëve në procedurat e prokurimit publik është që të nxisë biznesin e vogël dhe të mesëm. Gjithashtu nëse do të kishim një vlerësim të drejtë dhe jo tendencioz KVO do duhej të merrte informacion nga Zyra përkatëse që punimet e ngelura pa përfunduar nga objektet në fjalë kërkojnë fuqi punëtore cilësore tashmë pasi është kryer e gjithë puna sasiore, pra ka ngelur punë me manovrator dhe specialistë të fushës, punë të cilat kryhen në kohë shumë të shpejtë dhe që kërkojnë fuqi të paktë punëtore. Vëmë në dijeni KVO që në DST është kërkuar që numri mesatar i punonjësve për periudhen Mars 2017-Mars 2018 duhet të jetë 20 (Njzet) ndërkohë që ne kemi mesatarisht për këtë periudhë 35.8 punonjës pra 36 punonjës thuhet dyfishin. Kjo dhe fakti që punimet e ngelura janë që kërkojnë fuqi të paktë punëtore do të thotë që ne kemi aftësi dhe fuqi punëtore për të përfunduar me sukses kontratën në fjalë. Gjithashtu është e pa vend dhe tendencioze të mendosh që një operator ekonomik s'do duhej të punojë me dy turne apo me orare të zgjatura për të përfunduar një objekt, por të paragjykohet nga KVO dhe t'i thuhet që nuk ke fuqi punëtore, ndërkohë që po të kishte marrë informacion nga Zyrat përkatëse në institucionin tuaj dhe autoritetet tjera kontraktore që kemi punuar do ta dinte që ne jo vetëm i kemi përfunduar në kohë objektet, por shumicën e tyre i kemi përfunduar përpara afatit të përcaktuar nga AK në të gjitha kontratat që kemi patur. Operatorët e tjerë ekonomik nuk janë verifikuar për të njëjtin kriter skualifikues duke çuar në një vlerësim DISKRIMINUES dhe trajtim jo të barabartë të ofertuesve. 4. Kriteret e përdorura për të na skualifikuar janë DISKRIMINUESE për shoqërinë tonë pasi ato janë përdorur vetëm për ne dhe jo për operatorët tjerë në konkurim. Kjo faktohet duke ditur që të gjithë operatorët e tjerë konkurent në procedurën në fjalë kanë kontrata të lidhura ose në procedurë për t'i lidhur dhe KVO nuk ka bërë as verifikimin më të vogël në lidhje me angazhimin e tyre teknik në kontratat që kanë në proces. Kështu duke i

marrë me rradhë sipas renditjes po faktojme objektet të cilat kanë në proces operatorët konkurent në këtë procedurë....

Shoqëria SMO UNION së cilës oferta i është quajtur e vlefshme, ka lidhur kontratë me Bashkinë Shkodër në datë 14/05/2018 me shpallje në buletin NR.20 DT.21-05-2018 ku SMO UNION është Bashkim Operatorësh Ekonomik me SMO Vataksi, jemi të bindur që KVO nuk e ka verifikuar këtë kontratë dhe as nuk ka verifikuar nëse makineritë apo fuqia punëtore është e angazhuar dhe sa është e angazhuar. Gjithashtu KVO do duhej të dinte (sepse përderisa është kualifikuar si operator ka plotësuar deklaratën për punët në proces sipas DST) që Shoqëria SMO UNION ka një kontratë me KESH SHA të lidhur me datë 09/10/2017 me vlerë të kontratës 319 371 490 lekë me tvsh e cila ka një afat 12 mujor deri në 08/10/2018 dhe që është shumë e ngjashme me objektin në fjale, pra edhe kapacitetet teknike duhet të jenë të ngjashme dhe KVO do duhej t'i lindte dyshimi që ky operator mund t'i ketë makineritë e angazhuara apo ndonjë Inxhinier të paraqitur në këtë objekt (që është mbi 30 000 000 leke pa tvsh dhe kërkohet që të ketë një inxhinier drejtues teknik gjatë gjithë kohës në objekt). Arsyetimi i mësipërm është nisur nga arsyetimi që KVO ka përdorur për ne. Ne mendojmë që kualifikimi i SMO UNION dhe skualifikimi jonë është me tendencë pasi që verifikimet për makineritë dhe personelin duhen bërë për të gjithë operatorët ekonomik dhe jo vetëm për një operator. Më poshtë do të bashkëngjisim DST e dy objekteve që shoqëria SMO UNION (kemi marrë për bazë këtë operator ekonomik ngaqë është i renditur i dyti dhe nuk i është refuzuar oferta) ka të fituara, ku do të dallohet qartë që makineritë që janë të kërkuara janë të njëjtës natyrë me makineritë e kërkuara nga AK për objektin "Sistemim asfaltim rruga " Qendër Mes Qendër Dragoç". Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim ibarabartë i ofertuesve ose kandidatëve. Pra jemi në shkelje flagrante të ligjit për prokurimin publik sepse Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkodër është në të drejtën e saj, me të drejtën që i jep ligji si Autoriteti përgjegjës për prokurimin e fondeve publike të vëna në dispozicion që të kontrollojë dhe verifikojë kontraktuesit që kanë kontrata në proces me vetë Bashkinë Shkodër, makineritë, stafin, fuqinë punëtore në mënyrë që ofertuesi që shpallet fitues të jetë i gatshëm dhe të zotërojë të gjitha kapacitetet teknike në funksion të kontratës që do të realizojë POR ka edhe detyrimin ligjor që trajtimi i ofertuesve të jete i barabartë dhe jo diskriminues sepse TEKNIKISHT dhe ligjërisht angazhimi i makinerive, inxhinierëve dhe fuqisë punëtore ka efekt teknik dhe ligjor njësoj si me Bashkinë Shkodër ashtu edhe me autoritetet tjera kontraktore. Në shpjegimin e Bashkisë Shkodër në kthimin e përgjigjes punëtorët dhe makineritë e angazhuara në kontratat që kanë operatorët tjerë ekonomik nuk kanë të njëjtin efekt teknik dhe ligjor për tu skualifikuar nga Bashkia Shkodër si NE që jemi skualifikuar. Pra Bashkia Shkodër ka krahasuar objektet që kemi ne, që shumatorja e tyre në vlerë është rreth 25 000 000 lekë të reja me kontrata që kanë operatorët tjerë ekonomik konkurues që shkojnë në vlera mbi 300 000 000 dhe duke vlerësuar si të paarsyeshme verifikimin e makinerive, fuqisë punëtore dhe angazhimeve inxhinierike të atyre operatorëve ekonomike[...]"

II.7.Në datën 02.07.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.10281prot., datë 27.06.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Rroku Guest” sh.p.k. për vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : “-Nuk plotesoni pikën 2.3.13”Per Kapacitetin teknik” pasi makinerite e paraqitura ne kete procedure prokurimi deri me date 07.05.2018, dita e hapjes se ofertave, jane te angazhuara edhe ne kater kontrata te tjera te paperfunduara me Bashkine Shkoder si me poshte: 1-Rikonstruksion rruga "Sami Repishti“ 2- Ndërtim parcela të reja varresh Varreza NJA Rrethina, (Ndertim Varreza Publike) 3- Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Beltojë 4- Ndërtim trotuari nga kanali deri tek kisha, Sektor Velipojë” Te gjitha makinerite pa perjashtim te paraqitura ne shtojcen e makinerive jane te njejta me makinerite e paraqitura ne procedurat e cituara me lart ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në pikën 2.3.12, të shtojcës 12, “Për kapacitetin teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si vijon: “Ofertuesi duhet të disponojë minimalisht mjetet e mëposhtme për kryerjen e punimeve, me qëllim realizimin e objektit të prokurimit :

Nr	Mjetet	Sasia
1	Mjet transporti vetshkarkues ≥ 5 ton(ngarkesa)	1 cope
2	Mjet transporti vetshkarkues deri ne 3 ton(ngarkesa)	1 cope
3	Fadrom me goma	1 cope
4	Betoniere	2 cope
5	Rrul me vibrim	1 cope
6	Autobot uji	1 cope
7	Autobitumatrice	1 cope
8	Asfaltoshtruese	1 cope
9	Armature derrase	0.5m3
10	Matrapik	1 cope
11	Rrul me kompresor për ngjeshje asfalti	1 cope
12	Skeleri	100 m2

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 10 (dhjetë) copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 1 (nje) copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2 (dy) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 2 (dy) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 2 (dy) copë

Si deshmi për plotësimin e kesaj pike Operatori duhet të paraqesë:

- i. *Shtojcen nr. 10 të plotësuar.*
- ii. *Për mjetet në pronësi që shënohen në regjistra publikë, të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat , si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).*
- iii. *Për mjetet që nuk shënohen në regjistrat publikë, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e tyre: aktet e zhdoganimit në Republikën e Shqipërisë ose faturat tatimore të blerjes.*
- iv. *Për mjetet e marra me qira/furnizim, të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë/furnizimit ku të specifikohet afati i kontratës, shoqëruar me dokumentin që vërteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, taksat , si edhe çertifikatën për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).*
- v. *Për çdo automjet të paraqiten fotot përkatëse për identifikimin e targave të mjetit.*

Operatori ekonomik ofertues (Administratori i shoqërisë ofertuese), duhet të paraqesë deklaratë që makineritë e kerkuara në pikën 2.3.10, nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera por vetëm për këtë objekt. Gjithashtu në deklaratë duhet të deklarohet dhe vendndodhja e mjeteve në pronësi ose me qera me qellim verifikimi.”

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimes rezulton se është paraqitur shtojca përkatëse për makineritë “Mbi disponimin e makinerive” nga ku evidentohet se janë deklaruar për kryerjen e punimeve për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, makineritë dhe pajisjet si më poshtë vijon:

Ne pronësi

1. 2 Betoniere 0.5 m³ - Faturë Nr.98 datë 20.04.2010
2. Armaturë dërrase 6m³ - Faturë Nr.145 datë 10.11.2015
3. Asfaltoshtruese Bilelli+Rrul asfalti Bomag - Kontratë shitblerje nr.rep 135 nr.kol 75
4. Autobetoniere Dieci 3m³ - Deklaratë Doganore R4091 date 21.06.2013
5. Betoniere&Motorr(5 cope) + 7 Karroca – Faturë nr.908 datë 26.11.2014
6. Fadroma JCB – Targa AA697FV
7. Kamion mbi 20 Ton DAF – Targa SH7643E
8. Matrapik copë 2 – Faturë nr.113 date 23.04.2010
9. Rrul Terex 3 Ton – Deklaratë doganore R6396 datë 06.02.2010
10. Rrul gome cilindër mbi 12 Ton – Faturë nr.13 datë 17.02.2014
11. Skeleri – Faturë nr.13 datë 05.06.2017

Me qera

1. Autobitumatrice - Targa AA 230 HV, kontratë qiraje nr.rep 3148, nr.kol 2211
2. Autobot uji - Targa AA 703 OM, kontratë qiraje nr.rep 5940, nr.kol 1353
3. Kamion me vinc - Targa AA 043 KD, kontratë qiraje nr.rep 31, nr.kol 23

Gjithashtu nga ana e operatorit ekonomik ankimues rezulton se është paraqitur dokumenti “Deklaratë mbi angazhimin e makinerive”, sipas së cilës deklarohet se “[...]Makineritë e kërkuara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera por vetëm për këtë objekt[...]”. Ndërsa me anë të deklaratës “Deklaratë mbi kontratat e lidhura dhe/ose në proces”, të paraqitur nga ankimuesi, përfaqësuesi ligjor i operatorit ekonomik “Rroku Guest” sh.p.k. deklaroi se ky i fundit ka kontrata të lidhura dhe në proces me autoritetin kontraktor Bashkia Shkodër, me objekte si më poshtë:

1. “Rikonstruksion rruga “Sami repishti””, përfunduar 90% të punimeve.
2. “Ndërtim parcela të reja varresh NjA rrethina, (Ndërtim varreza publike)”, lidhur kontrata, në pritje të shpronësimeve.
3. “Rikonstruksion i rrugës së varrezave Beltojë”, përfunduar 65 % të punimeve.
4. “Ndërtim trotuari nga kanali deri tek Kisha, sektor Velipojë”, lidhur kontrata.

III.1.3. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të sjellë nga autoriteti kontraktor me shkresën nr. 10281 prot., datë 27.06.2018, rezultoi se operatori ekonomik ankimues “Rroku Guest” sh.p.k. ka deklaruar për kryerjen e punimeve për objektet “Rikonstruksion i rrugës së varrezave Beltojë” dhe “Ndërtim trotuari nga kanali deri tek Kisha, sektor Velipojë”, të njëjtat makineri dhe pajisje që ka deklaruar për kryerjen e punimeve për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, fakt ky i pranuar dhe nga vetë ankimuesi në ankesën e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*. Ndërsa në nenin 53, pika 3 të po këtij ligji, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”*.

III.1.5. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.6.Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, makineritë dhe pajisjet e paraqitura nga operatori ekonomik “Rroku Guest” sh.p.k. nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në kriterin e sipërcituar, pasi rezulton se këto mjete janë të angazhuara në kontrata të tjera të lidhura me të njëjtin autoritet kontraktor (Bashkia Shkodër). Operatori ekonomik ankimues nuk është në kushtet e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit pasi, në këtë rast, ky i fundit ka arritur të evidentojë jo thjesht e vetëm shpalljen fitues edhe në disa kontrata të tjera të ankimuesit, por edhe se të njëjtat mjete, të deklaruara nga operatori për këtë procedurë prokurimi objekt ankimi, janë të angazhuara edhe në kontratat e lidhur tashmë të cilat ende nuk kanë përfunduar apo ende nuk kanë filluar në datën e zhvillimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret, është vetë operatori ekonomik ankimues që ka bërë një deklaratë jo të saktë, nëpërmjet të cilës deklaron në mënyrë të veçantë për secilën procedurë më vete, se mjetet nuk janë të angazhuara në kontrata tjera.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues ”Rroku Guest” sh.p.k., për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimet e mësipërme nuk qëndrojnë pasi operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriterin e vecantë të kulifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

III.3.Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues ”Rroku Guest” sh.p.k. mbi kualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “S.M.O Union” sh.p.k, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se:

III.3.1.Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), parashikon se: *“Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.”*

III.3.2.Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të argumentojë se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP nuk mund të pranohet.

Neni 63, pika 1 kërkon shprehimisht që operatori ekonomik ankimues, jo vetëm që duhet të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit në KPP rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën se, pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës. Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm i drejtpërdrejtë nuk ka sesi të dëmtohet nga sukcesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Për këtë arsye, këto pretendime nuk do të mërren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Rroku Guest” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Sistemim, asfaltim rruga "Qendër Mes - Qendër Dragoç*”, me nr. REF-59821-03-29-2018, me fond limit 15,884,982 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 07.05.2018, nga autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1142 protokoli Datë 19.06.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha